



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.17/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Afijete Sada - Gllogjani, Faton Ademi, Kymete Kicaj, Milena Đerić, Zyhdi Haziri, Burim Ademi, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me nr. protokolli 244-2021 i datës 22.01.2021, për shkak të mos certifikimit së listës së kandidatëve për të garuar në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet pjesërisht apeli i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa **VËRTETOHET** vendimi Nr. 244-2021 datës 22.01.2021 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, në pjesën e refuzimit të rekomandimit të ZRPPC-së, për certifikimin e kandidatëve për deputet të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe atë: Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Liburn Aliu, Bajram Mavriqi dhe Labinotë Demi Murtezi.

II. Pranohet pjesërisht apeli i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, **NDRYSHOHET** vendimi Nr. 244-2021 i datës 22.01.2021 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, dhe vendoset si në vijim: Pranohet pjesërisht rekomandimi i ZRPPC-së, Certifikohet lista e kandidatëve për deputet të këtij subjekti politik, me përjashtim të kandidatëve të cekur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi.

III. Kandidatët për deputet të cekur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohen me kandidatë të tjerë.

A r s y e t i m

Me vendimin e KQZ-së, me nr. 244-2021 i datës 22.01.2021, është refuzuar rekomandimi i Zyrës për certifikimin e 110 kandidatëve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP-i, më datë 23.01.2021, ka pranuar një apel nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 244-2021 i datës 22.01.2021 me të cilin ka kërkuar, që të anulohet vendim i apeluar dhe të urdhërohet KQZ-ja, që ta certifikoj listën e tërësishme të kandidatëve për deputet të parashtruesit të apelit, sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim. Ngase sipas parashtruesit të apelit, ZRPPC-ja, është zyre profesionale dhe ligjore, e cila nxjerr rekomandime të mbështetura në kritere ligjore. Sipas rekomandimit të ZRPPC, përcaktohet qartë se lista e parashtruesit të apelit i ka përmbushur kriteret ligjore për certifikim. Mos votimi i listës prej 110 kandidatëve nga ana e KQZ-së, sipas rekomandimit të ZRPPC-së, është në kundërshtim të plotë me nenin 15, 25 dhe 26 të LZP-së, nenit 45 të Kushtetutës, nenit 3 të Protokollit të parë shtesë të Konventës Evropiane, Për Të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Mëtej parashtruesi i apelit thekson se mos certifikimi i personave në listën shtesë përbën cenimin të kushtetutës, instrumenteve ndërkombëtare dhe ligjeve vendore, duke i privuar nga e drejta për kandidim personat që iu janë shqiptuar masa të cilat nuk prodhojnë pasoja juridike, sipas nenit 100, të Kodit Penal, Nr.04/L-082. Sipas parashtruesit të apelit, neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton si vlerë themelore sundimin e ligjit, kurse neni 33 vendos për parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në përndjekjen e veprës penale dhe neni 45 po ashtu i kushtetutës, garanton të drejtën “të zgjedhë dhe të zgjedhet”. Po ashtu, neni 3 i protokollit të KEDNJ-së, mbron të drejtën e kandidimit.

Në apelin e paraqitur theksohet po ashtu se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin KO95/20, thirret në dokumente të Komisionit të Venecias, të cilat u kërkojnë shteteve të vepronë sipas parimit të proporcionalitetit dhe të shmangin rregullat që përgjegjësisht i ndalojnë kandidimin kujtdo që është shpallur fajtor për veprë penale, duke marrë parasysh natyrën e veprës ose sanksionit të shqiptuar. Kandidatët për deputet që janë në listën e parashtruesit të apelit Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu, janë dënuar në vitin 2018 me datë 13.09.2018, të cilët janë dënuar me Kodin Penal Nr.04/L-082, që ishte në fuqi, në kuptim të nenit 5, përcaktohet qartë se një ndër sanksionet e Kodit Penal, janë dënimet alternative. Në ndërlidhje me nenin 5 të Kodit Penal, neni 42 i kodit të njëjtë, përcakton qartë se llojet e dënimeve është dënimi alternativ. Në ndërlidhje me nenin 100 dhe 101 të Kodit Penal, tregohet qartë se kur fillojnë pasojat juridike të dënimit, pra këto pasoja nuk krijohen në rast shqiptimit të dënimit me kusht, vërejtjes gjyqësore ose kur kryesi lirohet nga dënimi. Parashtruesi i apelit potencon se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është shpallur fajtor kandidatja për deputete Labinotë Demi Murtezi, për shkak të veprës penale të kryer nga pakujdesia, të parashikuar me nenin 378 par.6 të KPK-së, (aksident trafiku me lëndim të lehtë) dhe iu është shqiptuar vërejtje gjyqësore. Kundër këtij vendimi s’ka paraqitur ankesë as prokurori e as pala, i cili aktgjykim është bërë i formës së prerë në fillim të janarit të vitit 2018, dhe në kuptim të nenit 103 par.2 nënpar.1 të Kodit Penal 04/L-082, vërejtja gjyqësore shlyhet nga evidenca pasi të kalojë një vit, nga dita kur është bërë i plotfuqishëm aktgjykimi. Në lidhje më këtë Kolegji i Gjyqtarëve ka marrë Aktvendim KP.nr.51/2021, i cili thekson se vërejtja gjyqësore siç ishte e dënuar Labinotë Demi Murtezi, nuk prodhon pasoja juridike sipas nenit 100 të Kodit Penal të lartcekur. Mirëpo

në këtë rast institucionet e drejtësisë kanë dështuar të fshijnë nga evidenca kandidaten në kohën e përcaktuar me ligj. Sipas parashtruesit të apelit KQZ-ja, ka zbatuar nenin 29 par. 1 pika "q" të LZP-së, ndërsa në anën tjetër nenin 100 par.1 dhe 2, i Kodit Penal të lartcekur, i përcakton pasojat juridike që mund të përcaktohen vetëm me ligj. Siç dihet vetëm Kodi Penal dhe askush tjetër, përcakton veprat penale, natyrën e veprave, llojin e dënimit dhe pasojat juridike. Paraqitësi i apelit ka propozuar që paneli të pranoj apelin, të anulohet vendim i apeluar dhe të urdhërohet KQZ-ja, që ta certifikoj listën e tërësishme të kandidatëve për deputet të parashtruesit të apelit, sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim.

KQZ-ja, në përgjigje në apel ka theksuar se parashtruesi i apelit e ka paraqitur aplikimin për certifikimin e kandidatëve për deputet duke e dorëzuar listën me emrat e 110 kandidatëve. Për të zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO95/20 të datës 06.01.2021 dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 29 par.1, të këtij ligji, KQZ-ja respektivisht ZRPPC-ja, ka bashkëpunuar me institucionet të cilat e kanë rolin e tyre për verifikimin e përputhshmërisë së kandidatëve. Me 20 janar 2021, ZRPPC, ka pranuar përgjigje se në listën e parashtruesit të apelit, janë 5 (pesë), kandidatë që kanë janë dënuar me vendim të formës së prerë në tri vitet e fundit. ZRPPC-ja, në ditën e njëjtë me datë 20.01.2021, e ka njoftuar parashtruesin e apelit se 5 kandidatë nga lista e subjektit politik, nuk janë në përputhshmëri me nenin 29 par.1 pika q i LZP-së, ngase janë dënuar këta kandidat me aktgjykime të formës së prerë dhe iu ka dhënë mundësia që ti zëvendësojnë deri me datë 21.01.2021 në ora 13:00. Mirëpo parashtruesi i apelit brenda afatit të caktuar nuk e ka bërë zëvendësimin e kandidatëve të cilët nuk ishin në përputhshmëri me nenin 29 par.1 pika q të LZP-së. KQZ-ja ka propozuar që të pranohet pjesërisht apeli i parashtruesit dhe të obligohet KQZ-ja, të certifikojë kandidatët të cilët i përmbushin kushtet ligjore nga neni 29 i LZP-së, ndërsa të refuzohet sa i për ketë pesë (5), kandidatëve të cilët nuk i përmbushin kushtet ligjore.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se ZRPPC-ja me datë: 22.01.2021 pas verifikimit të përshtatshmërisë së kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në kuptim të nenit 26 të LZP-së i ka rekomanduar KQZ-së, certifikimin e tërësishëm të listës së kandidatëve nga subjekti në fjalë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin e datës 22.01.2021, ka refuzuar rekomandimin e ZRPPC-së, e po ashtu ka obliguar ZRPPC-në, që ta njoftoj subjektin në fjalë për marrjen e vendimit të apeluar.

Sipas vlerësimit të PZAP-së, vendimi i apeluar i KQZ-së, është në kundërshtim me nenin 29 par. 1 pika q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili përcakton: *“Cili do person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”*, për shkak se shumica dërmuese e kandidatëve në listën e refuzuar të KQZ-së, nuk hyjnë në kategorinë e personave të pa përshtatshëm sipas nenit 29 të LZP-së.

Paneli, vlerëson se rekomandimi i ZRPPC-së, ka qenë në kundërshtim me nenin 29 të LZP-së, dhe po ashtu në kundërshtim me shkresat e lëndës me rastin e verifikimit të kandidatëve veç e veç, për shkak se nga shkresat mbi verifikimin e kandidatëve, shumica e kandidatëve, nuk kanë pasur ndonjë pengesë në kuptim të dispozitës së lartcekur për certifikim.

Përkundër verifikimit nga ana e KGJK-së bazuar në kërkesën e ZRPPC-se dhe gjetjeve si ne përgjigjen e KGJK-se, ZRPPC-ja hedh dyshime në saktësinë e te dhënave të përfshira në këtë përgjigje, e qe kjo bie në kundërshtim me nenin 329 paragrafi 1 i LPK-se, me të cilin përcakohet: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Rekomandimi i ZRPPC-së, po ashtu ka qenë në kundërshtim me pikën -II-, të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Veprimet verifikuese dhe hetuese të ZRPPC-së, kanë qenë në përputhje me nenin 26 të LZP-së, mirëpo rekomandimi nuk ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore të LZP-së, për arsye se:

Me nenin 26 paragrafi 1 i LZP-së, përcaktohet se: *“Zyra i bën një rekomandim të shkruar KQZ-së për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidatëve të pranuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas afatit për dorëzim të listave”*

Me nenin 26 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: *“Nëse Zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, në atë rast e njofton subjektin politik në fjalë që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda pesë (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/ se përse lista e tyre duhet korrigjuar”*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit, se me rastin e marrjes së vendimit të apeluar, lidhur me mos certifikimin e listës së kandidatëve për deputet të parashtruesit të apelit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë. Paneli, vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se: *“Cili do person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”*, siç edhe është në rastin konkret andaj është vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u mbështetur edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO95/2020 i datës 06.01.2021, në të cilin në pikën -II-, të dispozitivit është vendosur që në bazë të nenit 71.1

të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1 germa q) të LZP-së, personi i dënuar për vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit nuk mund të jetë kandidatë për deputet, e as të fitoj mandat të vlefshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili aktgjykim është i detyrueshëm për zbatim, për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me nenin 116.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhur me pretendimet se kandidatët si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk u është shqiptuar dënim që krijon pasoja sipas dispozitave të Kodit Penal, Paneli vlerëson se dispozita nga neni 29 par. 1 pika q) të LZP-së, nuk kërkon që të ketë pasoj juridike në raport me llojin e sanksionit penal. Në këtë kontekst edhe rrethanat tjera të nenit 29 të LZP-së, mundësojnë kufizimin e certifikimit madje jo vetëm kur kandidati ka një vendim penal të formës së prerë, mbi dënimin e tij, por edhe kur ekziston nën akuzë nga tribunali, siç është pika n), të nenit 29 të LZP-së, çka rezulton se qëllimi i kësaj dispozite ligjore nuk është për pasojat juridike që mund të ketë natyra e sanksionit penal të shqiptuar për vepër penale, por përfshin një mori situatash kur një kandidat për deputet nuk është i përshtatshëm për certifikim.

Paneli, i vlerësoi se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), është ligj special (lex specialis) në raport me Kodin Penal, krejt kjo duke u bazuar në parimin: “Lex specialis derogat lex generali” apo Ligji i veçantë e derogon ligjin e përgjithshëm, që e rregullon vetëm procesin zgjedhor, mirëpo nëse dy ligje rregullojnë situatën e njëjtë faktike, ligji që rregullon fushën specifike siç është LZP-ja, mbizotëron ndaj ligjit që rregullon vetëm çështje gjenerale (lex generalis). Në kuptim të kësaj Paneli, vlerëson se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë në nenin 29 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e), f), g), h), i), j), k), l), m), n), o), p), q), r) dhe pika s) përcaktojnë përshtatshmërinë/aftësinë e kandidatëve për tu certifikuar, në këtë rast kandidatët e cekur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi siç u arsyetua edhe më lart, nuk janë të përshtatshëm për tu certifikuar si kandidatë për deputet për shkak se janë në kundërshtim me pikën q) të dispozitivit të lartcekur dhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO95/2020 i datës 06.01.2021.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, nga verifikimet e bëra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kandidatet e propozuar në listën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti i dënuar sipas aktgjykimit Pkr.nr.717/2015, i formës së prerë nga data 13.09.2018, Albulena Haxhiu e dënuar me aktgjykimin PKR.nr.717/2015 i formës së prerë nga data 13.09.2018, Liburn Aliu i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.549/2016 i formës së prerë nga data 30.01.2018, Bajram Mavriqi i dënuar sipas aktgjykimit P.nr.103/2020 i formës së prerë nga data 03.11.2020, si dhe Labinotë Demi Murtezi e dënuar sipas aktgjykimit P.nr.3066/2016 i formës së prerë nga data 31.01.2018, të gjithë këta të dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata e vendit, andaj nga kjo rrjedhë se asnjëri nga këta kandidat nuk është i përshtatshëm konform nenit 29 par. 1 germa q) të LZP-së, dhe rrjedhimisht kjo përben ndalesë për certifikim të këtyre kandidateve, kështu që për këto rrethana edhe është vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi. Ndërsa afati tre

vjeçar siç është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 1 pika q) i LZP-së, në këtë rast është llogaritur duke ju referuar datës së aktgjyqimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç e deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve me datë 06.01.2021, si ditë përfundimtare për të vlerësuar afatin tre vjeçar, për përshtatshmërinë e kandidatëve në kuptim të dispozitës të lart cekur. Në këtë rast të gjithë kandidatët e mos certifikuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi nuk e kanë kaluar afatin e lartpërmendur tre vjeçar, siç përcaktohet me dispozitën e lartcekur.

Paneli, vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi për arsye se nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se kandidatët për deputet sipas listës së propozuar nga parashtruesi i apelit për certifikim, i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore dhe janë të përshtatshëm për certifikim, pasi që të njëjtit nuk kanë ndalesa ligjore për certifikim siç përcaktohet me nenin 29 të LZP-së dhe me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Kushtetuese.

Përveç tjerash, Paneli vlerëson se dispozita ligjore e nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është fuqizuar në atë masë sa që tani një dispozitë e tillë rangohet në normë kushtetuese apo standard kushtetues, e cila dispozitë mbizotëron në raport me të gjitha dispozitat tjera që i referohen përshtatshmërisë apo pengesave në certifikim të kandidatëve për deputet.

Paneli, vendosi si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, ngase mundësinë për zëvendësimin e kandidatëve brenda listës që nuk ishin të përshtatshëm me nenin 29 par. 1 pika q) të LZP-së, parashtruesi i apelit nuk e kishte shfrytëzuar edhe pse nuk është kontestuese për Panelin dhe palët në procedurë, se kjo mundësi iu ka dhënë parashtruesit të apelit sipas parashtrësës së dërguar me postë elektronike me datë 20.01.2021, mirëpo nuk i ka bërë zëvendësimet brenda afatit të caktuar nga ZRPPC,-ja, i cili afat për zëvendësim ishte deri me datë 21.01.2021 në ora 13:00.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet sipas apelit mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 17/2021 më datën 25.01.2021

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.